

AXHENDA

MBLEDHJA XXXIV KËSHILLI I INVESTIMEVE (KI)

***Për Konkurrueshmërinë dhe Rritjen e Aksesit në Tregje
të Produkteve Shqiptare me Standarde Evropiane***

Data: 03 Shtator 2024 ora: 11³⁰ – 13⁰⁰

Vendi: Salla Ovale, Pallati i Kongreseve

11:30 – 11:40	Mirëseardhje dhe Miratim i Axhendës së Mbledhjes <i>Z. Blendi Gonxhja, Kryetar i KI/Ministër i Ekonomisë, Kulturës, Inovacionit</i>
11:40 – 11:50	Prezantim “Për Konkurrueshmërinë dhe Rritjen e Aksesit në Tregje të Produkteve Shqiptare me Standarde Evropiane” <i>Sekretariati i Këshillit të Investimeve</i>
11:50 – 12:45	Diskutim i fokusuar nga Anëtarët e KI a) Si të përshpejtohet reforma në mënyrë që vendi të shndërrohet në eksportues neto me industri lokale me vlerë të shtuar të lartë deri në vitin 2030? Cilat janë angazhimet politike të MEKI-t në drejtim të infrastrukturës së cilësisë: si një qasje e orientuar nga tregu; përzgjedhja e sektorëve prioritarë; produktet me potencial për eksport; analiza mbi zinxhirin e vlerës apo “clusters”? Aderimi i Shqipërisë në tregun e përbashkët europian paraqet një sfidë të rëndësishme si për autoritetet shqiptare ashtu edhe për komunitetin e biznesit në drejtim të konkurrueshmërisë në një treg me standarde dhe infrastrukturë cilësore për produktet. b) Cilat janë kufizimet kryesore të tregut lokal?! Prodhimi i mallrave që plotësojnë kërkesat e standardeve të reja është kompleks, kryesisht për NVM-të për shkak të mungesës së njohurive rreth përfitimeve që ato ofrojnë, traditave të prodhimit dhe kostove përkatëse. Si të lehtësohet aksesimi në informacion dhe rritja e ndërgjegjësimit të tregut duke ndihmuar në zbutjen e kostos së pajtueshmërisë. c) Sigurimi i pajtueshmërisë me standarde në zinxhirin e furnizimit dhe Mbikëqyrja e Tregut. Sigurimi i mbikëqyrjes së tregut dhe koordinimi i përpjekjeve midis shtetit dhe komunitetit të biznesit do të krijonte kushte për një treg konkurrues, jo vetëm brenda rajonit, por edhe në një shkallë më të gjerë.
12:45 – 12:55	Raportim mbi statusin e Rekomandimeve të KI <i>Sekretariati i Këshillit të Investimeve</i>
12:55 – 13:00	Miratimi i Rekomandimeve dhe Mbyllja e Mbledhjes <i>Z. Blendi Gonxhja, Kryetar i KI/Ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit</i>